



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 37, paragrafi 3.1 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 10 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 për pranimin e personelit të përkohshëm në KQZ, si dhe Vendimit nr.1248-01-2024 të KQZ, të datës 21.08.2024, për miratimin e grupit të parë të pozitave për angazhimin e personelit të përkohshëm për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Emri i grupit</b>	Grupi i administrimit të përgjithshëm
<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar Administrativ
<b>Arsyeja për rekrutim kontraktual</b>	Për plotësimin e një pozite pozite në rast të mungesës së përkohshme
<b>Koeficienti/Paga</b>	5.25
<b>Nr. i kërkuar</b>	5
<b>Kohëzgjatja e emërimit</b>	Emërimi me afat të caktuar
<b>Data e njoftimit</b>	07/09/2024
<b>Afati për aplikim</b>	07/09/2024 - 11/09/2024
<b>Institucioni</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>Departamenti</b>	Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike
<b>Divizioni</b>	Zyra e Drejtorit të Zyres për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike
<b>Vendi i punës</b>	Prishtinë
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00015064
<b>Kodi</b>	RPC0008603



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Pranon dhe klasifikon kërkesat e parashtruara për deklaratimet e koalicionëve;
- Mban dhe përditëson të dhënat në lidhje me deklaratimin e mos pjesëmarrjes në zgjedhje të partive politike të regjistruara;
- Pranon dhe klasifikon aplikacionet dhe dokumentet mbështetëse për certifikim të subjekteve politike;
- Kontrollon listën e kandidatëve të subjekteve politike që kanë aplikuar për certifikim në zgjedhje;
- Pranon dhe klasifikon dokumentet e aplikimit për organizatat vëzhguese;
- Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Zyrës, bënë vlerësimin e dokumenteve të aplikimit për certifikim të dorëzuara nga subjektet politike;
- Nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të njësisë, bënë vlerësimin e dokumenteve të aplikimit për akreditim të organizatave vëzhguese;
- Kontrollon të dhënat në fletëvotimet e miratuara nga KQZ, si: emrin e subjekteve politike, akronimin dhe emrat në listën e kandidatëve;
- Klasifikojnë dhe shpërndajnë distinktivët për organizatat vëzhguese të akredituara;
- Ndihmojnë Njësinë e kontrollit financiar të subjekteve politike, në pranimin dhe klasifikimin e raporteve të deklaratimit financiar të fushatës së zgjedhjeve dhe mbulojnë të dhënat personale para publikimit në ueb faqen e KQZ;
- Kryen detyra tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi.

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë, më së paku 3 vite të studimeve.
- **Kërkesat specifike:** Nuk ka
- **Përvoja e punës e kërkuar:** së paku një (1) vit përvojë pune.

### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Njohuri në fushën profesionale specifike;
- nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
- njohuri të mira të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe, për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- aftësi komunikimi dhe ndikim personal;
- njohuri kompjuterike.



## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

- Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës/ certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjen e diplomës së kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionit arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurën e nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/ kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucionin publik (vlen për të punësuar në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetë deklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve të aplikimit të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaratat në aplikacion.

### Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit.

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/ e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore;
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 26/09/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 7. Kriteret specifike shtesë

---

Të mos ketë qenë anëtar i një subjekti politik në tri (3) vjet para paraqitjes së aplikimit për këtë pozitë;

Pika më lartë në "Kërkesat shtesë sipas legjislacionit në fuqi" sipas kërkesës së NJMBNJ, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike në KQZ, bënë verifikimin për kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë .

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervista – maksimumi 100 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bënë verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinale apo të njësuar me origjinalin.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen



